Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës
02 Nr. 400/01-46820 dt. 30/10/ 2026

Bazuar në nenin 11, 12, 40 Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës''), nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.10.2026 miratoi këtë:

V e n d i m
Për diskutim të raportit të auditimit të pajtueshmërisë "Menaxhimi i pronave të dhëna me qira në Komunën e Gllogocit për periudhën 2024-2025

Neni 1

Më këtë Vendim Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt miratoj diskutimin publik të raportit të auditimit të pajtueshmërisë "Menaxhimi i pronave të dhëna me qira në Komunën e Gllogocit për periudhën 2024-2025.

Neni 2

Në këtë diskutim do të debatohen të gjeturat dhe rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm lidhur me menaxhimin e pronave të dhëna me qira në Komunën e Gllogocit për periudhën 2024-2025.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi janë përgjegjëse Kuvendi Komunal dhe Zyra e Kryetarit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Bujupi

Vendimi i dërgohet:
- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

ARSYETIM

Komuna e Drenasit me datë 09.10.2026 nga Vlora Spanca, auditorë e përgjithshme e Republikës së Kosovës kemi pranuar raportin e auditimit të pajtueshmërisë "Menaxhimi i pronave të dhëna me qira në Komunën e Gllogocit për periudhën 2024-2025 së bashku me të gjeturat dhe rekomandimit të tij, ku duke marrë parasysh këtë dhe nevojës së shqyrtimit të të njëjtit ,Kryetari i Komunës përmes këtij propozim vendimi i propozon Kuvendit të Komunës që duke marr parasysh legjislacionin në fuqi dhe nevojës për diskutimin dhe trajtimin me prioritet të raportit në fjalë që synon adresimin dhe zgjedhjen e problemeve të kësaj natyre në nivel lokal të votohet ky propozim vendim.

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-692/5
Data Datum Date 04.11.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	**Ramiz Lladrovci**, Kryetar i Komunës së Gllogocit **Burim Bujupi**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gllogocit	
Kopje:	**Elbert Krasniqi**, Ministër në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Nga:	**Jeton Qela**, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Datë:03.11.2026 -VI-020-692
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Komunë 2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	**Erblin Hetemi**, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL **Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë se Akteve të Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit **Diturie Bekteshi**, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë se Akteve Komunale	
Lënda:	Shkresë përcjellëse	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 8, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, marrë parasysh se ky vendim nuk bënë pjesë të vendimet e përgjithshme të kuvendit të komunës vlerëson se:

- *Vendimi 02 Nr.400/01-46820 për diskutim të raportit të auditimit të pajtueshmërisë "menaxhimi i pronave të dhëna me qira në Komunën e Gllogocit për periudhën 2024-2025 , nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë.*

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.